MBRETNIJA SHQIPTARE

ESAD BEILERI NOTER PUBLIK

D U R R E S

Nr.406 Repertor

Nr.281 Koleksion

Proces-verbal

N'EMEN TE NALT MADHNIS SE TIJ

Z O G I

ME VULLNET TE POPULLIT MBRET'I SHQIPTARVET

---

Sot me daten tre te muejit Tetuer, te vjetit njimijenandeqindetridhete-tre, diten e Mart, ora pese e pesmbedhjet minuta mbas dite, mbi lutjen e Z. Jorgji Veveçkes banues ne Tirane, provizorisht ne Durres i cili me kerkoj çeljen e publikimin e nji testamenti te mshehet depozituem nga ana e te ndjerit Miltiadh Shallvari prane ksaj arshive me Nr.1, i Repertorit te vullnetit mbr më date tete Maj 1929 tue i bashkanjit dhe akt-njoftunin te Gjyqit Paqit Durresit me Nr.37 date 17.7.1933 me te cilen vertetohet se, i ndjeri Miltiadh Shallvari ja vdek me daten shtatembedhjet Maj njemijenandeqindetridhetetre, keshtu zotnija e tij nalt permendun tue kujtue se, ka interese ne testamentin ne fjale deshirojti çeljen e publikimin prane ksaj Noterije ne kete menyre, ne konformitet te ligjavet ne veprim ju shkrue Gjyqit Paqit Durresit dhe keshtu ne diten e ne oren e sipershenueme u gjenden ne kete Zyre Notariale Gjyqtari Paqtues Z.Hyqmet Meçja, dhe Z.Jorgj Veveçka i biri i te ndjerit Sotir lindun ne Durres, banues ne Tirane per kete çeshtje ne Durres, vjeç (43 dyzet e tre) i njohun ndaj meje e dishmimtarvet ZZ.Anastas Voilla i biri i Vangjelit lindur e banues ne Durres dhe Dimesten Moisiu i biri Anastasit lindun e banues ne Durres te njohun ndaj meje madhore e pa ndalim ligji dhe si dragoman Z.Moisi Peppa i biri Themistokliut lindur e banues ne Durres Farmaçist, vjeç (33 tridhjetetre) i betuem se, per kethimin ka me e ba te drejte e me ndergjegje te paster dhe keshtu u krye testamenti nga kje arshive i mbyllun ne nje pliko te verdhe i zamkosun me pes vula (Miltiadh Shallvari Krushkull Durazzo) me dyll ngjyre jeshile po mbi kete pliko shkrojtur dhe proçes-verbali i depozitimit nga ana e ndihms Gjyqtarit Paqtues te Durresit me detyre Noteri Z.Dud Petraq Gjeçi, me date e Merkure tete Maj njemijenandeqindenjizetenande ora dymbedhet para dreke dhe i nenshkruem prej testatorit Miltiadh Shallvarit e deshmimtarevet Sa. Giuseppe Grillo, Pietro Benani, Ndrek Kacarezi e Dr.Terenc Toçi dhe dragoman Stefan Kaçulini. Dhe keshtu kj pliko mbasi u pa se, nuk qe i çar, i grisun ose i venuemun ndenji ane u çel para te gjitheve ne te cilen u gjend nje karte e bardhe pa vija dy faqeshe e shkruem ne nji faqe me boje ne gjuhen italishte e perbame prej katermbedhjet rreshtash dhe e nenshkrueme me emen Miltiade Sallvari nen të vulosun me vulen Miltiadh Shallvari Rrushkull Durazzo. Dhe keshtu mbasi u nenshkru ne te gjitheve karta qi permban testamentin u perkethye fjale per fjale ng gjuha italishte ne gjuhen amtare prej dragomanit siper-permenduh Z.Moisi P pa, rreshtohet ketu poshte gjendja e tij .........................................

Diten tete te muejit Maj, te Merkuren vite njimijenandeqindenjizet n nte n'Hotel Splendid Palas ne Durres, un i nenshkruemi Miltiadh Salvari isb Kostantin (me ortografin shqiptare Shallvari) baj te dispanueme gjithe pjesen e pasunis s'eme te tundeshme dhe te pa tundeshme, pa perjashtue kurgja se dashmes dhe te mires gruas s'eme Llava Lubica Lliubizza. Per deklarej qi vllai im Nicola ose aij qi ze vendin per të te dije dhe te kete nder mend që dishiri i zemres s'eme asht qi te rinoncoj ne favor te gruas s'eme te de shmen, pjesen qi mundet t'i perkasi si mbas ligjit ne baze te ktij testamenti. E keshtu affidohem te dashurin e tij vllaznere.........................

Miltiadh Shallvari

Pra mbasi testamenti i çelun u ba me dijt gjithe kerkuesit, u nensh prej meje Noterit, Gjyqtarit Paqtues, kerkuesit dhe dishmimtarvet e dra nit nalt-treguem tue ju bashkanjit akt-njoftunija e vdekjes. Ky proçes i shkruem me dy faqe keter u kendua nga ana ime ne pranesi te deshmim ve te gjitheve dhe u ba me dy kopje dhe u nenshkrue prej te gjith mbet n'arshiven noteriale testamenti me plikon e aktet tjera te r ma siper.......................................................

Durres, me 3 Tetuer 1933

Deshmimtare : Anastas Voilla d.v. Demosten Moisiu d.v.

Gjyqtari Paqtues: H.Meçia d.v.

Kerkuesi: Jorgji Veveçka d.v.

Noteri E.Beileri e Vula